UDHËZIM
Nr. 65, datë 4.2.2021

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR FITIMIN, HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS, TË PROCEDURËS PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, SI DHE TË PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 6; të pikës 7, të nenit 8; të pikës 3, të nenit 10; të pikës 2, të nenit 11; të pikës 2, të nenit 13; të pikës 1, të nenit 17; të pikës 3, të nenit 18; të pikës 1, të nenit 19; dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë",

UDHËZOJ:

I. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME ORIGJINË

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinë shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuesit me të paralindurit.

a) kërkesë e shtetasit drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikatë personale dhe familjare;

c) certifikatë apo çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit vërtetohet origjina shqiptare e kërkuesit, në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, qoftë dhe nga njëri prind;

d) dëshmi penaliteti, të lëshuar nga shteti ku është rezident;

e) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE ME NATYRALIZIM

1. I huaj mbi 18 vjeç, me qëndrim të rregullt në Shqipëri:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

d) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

g) kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (fotokopje e noterizuar);

h) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

i) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

j) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

k) mandatpagesë.

2. Person pa shtetësi:

a) kërkesë e personit pa shtetësi drejtuar Presidentit të Republikës;

b) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

c) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit, që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

e) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

f) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

g) mandatpagesë.

3. I huaji i martuar me shtetas shqiptar:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikata e lindjes dhe familjare;

c) certifikatë martese.

d) lejeqëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

g) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

h) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore për sjelljen dhe për qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga seksioni i policisë kriminale);

i) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

j) mandatpagesë.

4. I huaji, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) certifikata e lindjes dhe familjare;

d) certifikata e lindjes së fëmijës me shtetësi shqiptare;

e) leje qëndrimi të vlefshme e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

f) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 (tre) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

g) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

h) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

i) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit;

j) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin. Ky dokument duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit. Mendimi duhet të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në Shqipëri, precedentin e tij penal (nëse ka);

k) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

l) mandatpagesë.

5. Fëmija i dy prindërve që kanë fituar shtetësinë me natyralizim:

a) kërkesë nga të dy prindërit ku shprehet dhe pëlqimi i fëmijës kur është në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç, drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç;

c) certifikata e lindjes dhe familjare ku te evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga dy prindërit;

d) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

f) fotografi e aplikantit, tri copë;

g) mandatpagesë.

6. Fëmija i një prindi që ka fituar shtetësinë me natyralizim:

a) kërkesë nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve (në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin me shkrim) dhe pëlqimi i fëmijës, kur është në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç, drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokumentet për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) dhe të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç;

c) certifikata e lindjes dhe familjare ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga njëri prind;

d) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

e) dëshmi e gjendjes gjyqësore e marrë në vendin e origjinës, në një shtet të tretë dhe në vendin ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtë muajt e fundit, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

f) fotografi e aplikantit, tri copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);

g) mandatpagesë.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME BIRËSIM:

a) kërkesë e bashkëshortëve drejtuar Presidentit të Republikës;

b) akti i lindjes së fëmijës/certifikatë nga akti i lindjes;

c) dokumenti, akti administrativ, mbi bazën e të cilit është vendosur për birësimin e fëmijës;

d) deklaratë noteriale e prindërve.

IV. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR FITIMIN E SHTETËSISË NGA REFUGJATËT, APO PERSONA NË MBROJTJE PLOTËSUESE:

a) kërkesë e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;

b) dokument për nivelin A2 të njohurive të gjuhës shqipe (lëshuar nga institucioni përkatës arsimor) të ketë kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë;

c) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noterizuar);

d) vërtetim nga Autoriteti i Kufirit dhe Migracionit qe ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) akti i pronësisë së banesës ose kontrata e marrjes me qira të banesës (fotokopje e noterizuar);

f) kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (fotokopje e noterizuar);

g) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

h) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

i) vendimi për fitimin e statusit (fotokopje e noterizuar);

j) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, për sjelljen e qëndrimin e tij/saj në Republikën e Shqipërisë (përpilohet nga sektori i policisë kriminale);

k) mandatpagesë.

V. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

1. Për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, shtetasi shqiptar depoziton:

a) kërkesë e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës;

b) premtimi nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument origjinal, ku konfirmohet shtetësia e vendit tjetër;

c) certifikatë lindjeje e aplikuesit*;

d) certifikatë familjare e aplikuesit*;

e) vërtetim i gjendjes gjyqësore*;

f) vërtetim i lëshuar nga Gjykata e rrethit*;

g) vërtetim i lëshuar nga prokuroria e rrethit*;

h) vërtetimi i lëshuar nga zyra e përmbarimit*;

i) dokumenti që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili është premtuar shtetësia tjetër;

j) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin. Ky dokument duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit. Mendimi duhet të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në Shqipëri, precedentin e tij penal (nëse ka).

2. Për fëmijët e moshës 0–14 vjeç të paraqitet:

a) kërkesë e prindërve apo e kujdestarit ligjor drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikatë lindjeje e fëmijës;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie nga një vend tjetër).

3. Për fëmijët e moshës 14–18 vjeç, dokumentacioni duhet të paraqitet i plotë, sipas përcaktimeve të pikës 1, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, si dhe deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve apo kujdestarit ligjor sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre.

Koment. Dokumentet, të cilat kanë shenjën "", merren në Republikën e Shqipërisë.*

VI. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Ish-shtetasi shqiptar, që nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikatë personale dhe familjare;

c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe aktualisht është person pa shtetësi;

d) vërtetimin e njësisë administrative përkatëse për çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç;

e) certifikatë lindje ose vdekje të prindërve të çdo aplikanti;

f) relacion shpjegues dhe konfirmimi nga komisariati i policisë vendore dhe prefektura përkatëse, lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë pasur prindërit e çdo aplikanti (ky relacion përpilohet nga komisariati i policisë vendore, seksioni i policisë kriminale dhe Prefektura e qarkut);

g) fotografi e aplikantit, 3 (tri) copë (në rast se ka fëmijë nën moshën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).

2. Ish-shtetasi shqiptar që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, depoziton:

a) kërkesë e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës;

b) certifikatë lindjeje dhe familjare;

c) dëshmi penaliteti të lëshuar në vendin e shtetësisë tjetër që ka aplikanti;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

e) dokument i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

VII. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Kërkesa për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare paraqitet pranë strukturave vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, të vendbanimit të personit.

2. Aplikimi për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj, bëhet nga vetë kërkuesi (për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare nuk aplikohet nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme). Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, përveç të miturve nën moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit apo kujdestari ligjor i tyre.

3. Kërkesa i drejtohet Presidentit të Republikës dhe duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, atë të përkohshme, adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij. Në përmbajtje të kësaj kërkese duhet të parashtrohen qartazi arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare, periudha e ardhjes në Shqipëri, profesioni i ushtruar në shtetin e huaj dhe në Shqipëri. Aplikanti duhet të sqarojë në mënyrë të hollësishme, duke përshkruar gjithë veprimtarinë e jetës së tij. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë dhe datë nga aplikuesi.

4. Dokumentet për shtetësinë shqiptare pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin, pa gabime e pa korrigjime në përmbajtjen e tyre. Dokumentet pranohen në formën e tyre origjinale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveç rasteve kur për dokumentet e ardhura nga jashtë është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit, atëherë pranohen dokumentet e njësuara me akt noterial.

5. Dokumentet e lëshuara nga administrata e shtetit të huaj duhet të jenë të legalizuara secili më vete, në vendin ku ato janë lëshuar, përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Data e lëshimit të tyre të mos kapërcejë gjashtë muajt e fundit. Afatet e vlefshmërisë llogariten mbi bazën e datës së pranimit të dokumenteve nga drejtoria e vendore e policisë (ose komisariati i policisë vendore).

VIII. PROCEDURA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

1. Pranimi i aplikimit për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Në zbatim të këtij udhëzimi, procedurat e pranimit të kërkesave nga strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe dhëniet e mendimit nga specialistët e policisë kriminale, përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Për aplikimet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare, Ministria e Brendshme/Sektori i Shtetësisë, vijon me verifikimin e tyre, vetëm në rastet kur aplikimet përcillen nga misionet diplomatike apo postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Në këto raste, punonjësi përgjegjës, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, harton shkresën për çdo aplikues dhe e përcjell atë pranë drejtorisë vendore të policisë, Sektori i Rendit dhe i Sigurisë Publike.

4. Për heqjen e shtetësisë pa kërkesë, në rastet e përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", pas marrjes së informacionit, Ministria e Brendshme, Sektori i Shtetësisë, përgatit shkresën së bashku me materialet përkatëse dhe përcjell për verifikime informacionet e marra në organet ligjzbatuese.

IX. PROCEDURA PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Personi që fiton shtetësinë shqiptare, pas botimit të dekretit të Presidentit në Fletoren Zyrtare, brenda gjashtë muajve, kryen betimin për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij.

2. Betimi për fitimin e shtetësisë shqiptare kryhet nga të gjithë personat, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, me përjashtim të atyre personave, të cilët janë në kushte të pamundësisë për t'u paraqitur në zyrën e gjendjes civile në bashki /njësi për arsye të justifikuara shëndetësore.

3. Me marrjen e njoftimit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, personat që u është miratuar shtetësia shqiptare paraqesin në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative dokumentacionin e nevojshëm, të lëshuar nga vendi i origjinës, siç janë dokumentet certifikatë personale, certifikatë familjare dhe certifikatë martese, të përkthyera në gjuhën shqipe, me vulën APOSTILLE ose të legalizuara.

4. Pas dërgimit të dekretit për fitim të shtetësisë shqiptare, zyrës respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, paracaktohet në shpallje të lirë publike, data dhe ora e betimit, e cila i korrespondon çdo dite të hënë.

5. Njoftimi për datën e kryerjes së betimit dërgohet në adresën e personit, të cilit i është dekretuar fitimi i shtetësisë shqiptare.

6. Në rastet e fitimit të shtetësisë, sipas nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

7. Në përfundim të procedurës së betimit, zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe më pas personi që ka kryer betimin, efektivisht shtetas shqiptar, aplikon për pajisje me dokumentin e identifikimit, letërnjoftim dhe pasaportë.

X. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Në rast të moszbatimit të afatit 6-mujor (gjashtëmujor) për kryerjen e betimit në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, për shkaqe të justifikuara objektive dhe të arsyeshme, personi, i cili e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin, duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa parashikohet se mund të zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

2. Në çdo rast, ky afat duhet t'i korrespondojë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, "Për

shtetësinë". Në këtë rast personi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë Ministrisë së Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

3. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve, të cilat shqyrtohen nga struktura për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, lëshohet konfirmimi për pranimin/mospranimin e kërkesës, i cili më pas i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila e adreson për ndjekje të mëtejshme në zyrën respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, për vijimin e procedurës së betimit për fitimin e shtetësisë shqiptare.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi